



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

NJOFTIM PËR VEND PUNE

**SHPLLJE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË
PËR KATEGORINË E ULËT DREJTUESE**

Për procedurat (lëvizje paralele/ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Pozicioni i mësipërm u ofrohet nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se këto pozicione janë ende vakant, ato janë të vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

I. LËVIZJE PARALELE BRENDË SË NJËJTËS KATEGORI

Shpallje për lëvizjen paralele brenda së njëjtës kategori për plotësimin e vendit të lirë të punës në AKEP.

1. Në zbatim të Kreut V të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe Kreut II, të VKM-së nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) shpall procedurat e lëvizjes paralele brënda së njëjtës kategori, për pozicionin:

Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, Analizës, Tarifave dhe Statistikave
Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore
Kategoria e pagës III-a (III-1)

2. **Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:**

- MISIONI :

Siguron me profesionalizëm dhe përgjegjësi zbatimin e funksioneve të njësisë organizative në kuadër të veprimtarisë së AKEP si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe postare, lidhur me analizën e tregjeve përkatëse, mbikëqyrjen dhe rregullimin e tarifave të ofrimit të shërbimeve, vendosjes së masave rregullatore si dhe administrimit dhe përpunimit të të dhënave, sipas ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS:

Përgjegjësi i Sektorit të Kërkimeve, Analizës, Tarifave dhe Statistikave përgjigjet përpara Drejtorit të Drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore për përmbushjen nga sektori që drejton, të funksioneve në lidhje me analizën e tregjeve përkatëse, mbikëqyrjen dhe rregullimin e tarifave të ofrimit të shërbimeve, vendosjes së masave rregullatore si dhe administrimit dhe përpunimit të të dhënave, sipas ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim që të mund të përmbushet misioni dhe objektivat rregullatore.

- DETYRAT KRYESORE

Përgjegjësi i Sektorit të Kërkimeve, Analizës, Tarifave dhe Statistikave siguron që:

1. T'i japi hollësi e nevojshme eprorit direkt me qëllim që funksionet e drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore në lidhje me analizën e tregjeve përkatëse, mbikëqyrjen dhe rregullimin e tarifave të ofrimit të shërbimeve, vendosjes së masave rregullatore si dhe administrimit dhe përpunimit të të dhënave, sipas ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, të zbatohen nga nëpunësit në përbërje të sektorit duke bërë ndarjen e punës sipas pozicioneve dhe detyrave përkatëse, për zbatimin e procedurës dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore të parashikuara në legjislacionin material të fushës dhe atë të përgjithshëm, si dhe të realizimit të objektivave sipas strategjisë dhe planit të veprimit.
2. T'i japi hollësi eprorit direkt me qëllim që të sigurojë që njësitë organizative në përbërje të drejtorisë, të ushtrojnë veprimtarinë dhe përmbushin detyrat sipas funksionit që kanë, si dhe të bashkërendojnë dhe koordinojnë aktivitetin për të garantuar mbarëvajtjen e proceseve të punës sipas procedurës, që nga marrja e detyrave deri në përmbushjen e plotë të tyre.
3. Proceset e punës dhe detyrat e ngarkuara nga Titullari për sektorin, të realizohen me cilësi, efektivitet dhe brenda afateve ligjore.
4. T'i japi hollësi eprorit direkt që procesi i raportimit në çdo nivel sipas hierarkisë të jetë i qëndrueshëm, eficient dhe në funksion të qëllimit për të cilin zbatohet.
5. T'i japi hollësi eprorit direkt që bashkëveprimi dhe përmbushja e detyrave të caktuara nga Titullari në kuadër të grupeve të punës dhe bashkëpunimit me drejtoritë e tjera të AKEP të kryhet sipas procedurës, akteve të nxjerra për këtë qëllim si dhe efektshmëri të plotë.
6. Të japi hollësi që mbikëqyrja dhe monitorimi i tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike për tregun e shumicës dhe atë të pakicës të kryhet rregullisht dhe në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore.
7. Të japi hollësi që analizat e tregjeve sipas përcaktimeve ligjore të kryhen në afatet e parashikuara ligjërisht dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet rregullatore në fuqi.
8. Të japi hollësi që vendosja e masave rregullatore për sipërmarrësit e deklaruar me Fuqi të Ndjeshme në Treg të zbatohet në përputhje me rezultatet e analizave së tregjeve përkatëse dhe kuadrit ligjor dhe rregullator për këtë qëllim.
9. T'i japi hollësi eprorit direkt që të përgatiten rekomandimet dhe opinionet e karakterit rregullator për Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, për çdo çështje në shqyrtim si dhe për çështje që lidhen për dhënien e mendimit institucional mbi projektakte ligjore dhe nënligjore të adresuara nga organet që disponojnë sipas Kushtetutës dhe ligjit të drejtën e nismës ligjore.

10. Të japi hollësi që administrimi dhe përpunimi i të dhënave statistikore të depozituara nga sipërmarrësit të kryhet në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të AKEP.
11. T'i japi hollësi eprorit direkt që bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës, të garantojë zbatimin e detyrimeve ligjore dhe të shërbejë për marrjen e masave preventivuese sa më të efektshme për parandalimin e sjelljeve antikonkurrese nga ana e sipërmarrësve në dëm të konsumatorit/përdoruesve.
12. T'i japi hollësi eprorit direkt që sipërmarrësit dhe AKEP të përmbushin detyrimet ligjore lidhur me transparencën dhe publikimin e informacionit për përdoruesit e rrjeteve/shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe ato të shërbimeve postare.
13. T'i japi hollësi eprorit direkt që përditësimi i informacionit të ardhur nga organizatat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë dhe AKEP aderohet, për çështjet që lidhen me funksionet e sektorit, të shërbejë për zbatimin e detyrimeve ligjore, përmirësimin e kuadrit rregullator dhe rritjen e standardeve të punës në këtë drejtim.
14. Të japi hollësi që kontributi i drejtorisë në lidhje me procedurat për planifikimin dhe zbatimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe buxhetit të AKEP, të kryhet në kohë, me cilësi dhe efektivitet.

3. Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:

Arsimi : Të zotëroje diplomë “Master Shkencor” në fushën e Shkencave Ekonomike.

Përvoja : Të ketë eksperiencë profesionale në fushën e rregullimit ekonomik, në fushën administrative, dhe organeve rregullatore të fushave të tjera.

Të tjera : Të detyrueshme,

- Njohuri të thelluara dhe eksperiencë profesionale, në nivelin menaxherial në fushën e rregullimit ekonomik.
- Njohuri shumë të mira praktike në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve aplikative të administrimit të të dhënave dhe aftësi për të përpunuar të dhëna teknike.
- Njohja e gjuhës angleze e certifikuar në nivel profesional. Çdo gjuhë e huaj tjetër përbën avantazh.
- Aftësi analitike dhe krijuese për zgjidhjen e situatave komplekse.
- Njohuri dhe interes i vazhdueshëm për të qenë në korrent të parimeve dhe praktikave më të mira për rregullimin e konkurrencës *ex-post* në vendet e BE dhe më gjerë.
- Njohuri dhe interes i vazhdueshëm për të qenë i informuar vazhdimisht me vendimet e nxjerra nga Këshilli Drejtues, organizatat ndërkombëtare të fushës ku Republika e Shqipërisë/AKEP aderohet të cilët janë gjithnjë orientues në punë.
- Aftësi vet-motivuese për të punuar i pavaruar brenda afateve kohore të ngushta në një mjedis pune intensiv, me qëllim përgatitjen e dokumenteve rregullatore.
- Aftësi vet-organizuese, dhe aftësi krijuese për të dhënë sugjerime dhe propozime të dobishme për ecurinë e punës.
- Aftësi shumë të mira për të relatuar me shkrim dhe me gojë në nivelet më të larta drejtuese.
- Të ketë aftësi koordinuese e mbikqyrëse të punës në drejtori.
- Të ketë cilësitë e nevojshme për të drejtuar punën në grup.

4. **Kushtet minimale** që duhet të plotësojnë kandidatët për këtë procedurë, janë:
- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
 - b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - c- Të ketë, të paktën, vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;
 - ç- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posacme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
5. **Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokollit të AKEP, dokumentet e dosjes së tij personale:**
- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
 - Jetëshkrimi CV (mund të hartohet në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun [http://dap.gov.al/vende -vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta](http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta))
 - Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
 - Fotokopje të letërnjoftimit (ID) ose Pashaportës.
 - Fotokopje të diplomave.
 - Fotokopje të listës së notave.
 - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë).
 - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
 - Aktin e emërimit si nëpunës civil.
 - Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
 - Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
 - Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
 - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
 - Formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas linkut <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-i-vetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-ose-ushtrojne-funksione-publike>
6. Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e Protokollit, të Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Rr. Reshit Çollaku, brenda datës **29.03.2024**.
7. **Rezultatet për verifikimin paraprak** të kushteve minimale të procedurës lëvizje paralele brenda së njëjtes kategori dhe të përmbushjes së kriterëve specifike të vendit të punës do të dalin në datë **02.04.2024** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të AKEP. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.
8. **Konkurimi -Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **12.04.2024** ora **12:00**.

9. Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Punes
- Kodi i Procedurave Administrative
- Kodi Civil
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore të tij;
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligjin 119/2014 “Për të drejten e informimit”
- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
- Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” i ndryshuar
- Ligjin nr. 9918, datë 19.08.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, (<http://www.akep.al/legjislacioni/ligje>)
- Ligjin Nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” (<http://www.akep.al/legjislacioni/ligje>)
- RREGULLORE
<https://akep.al/legjislacioni/rregullore>
<https://akep.al/sherbim-postar/rregullore>
- <http://www.akep.al/legjislacioni> (Ligj, VKM, Rregullore, në faqen zyrtare të AKEP)

10. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Levizje Paralele (KPLP) i ngritur në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- 40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnime dhe kualifikime në fushën përkatëse, si dhe 10 pike për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.
- 60 pikë** për intervistën e strukturuar me gojë.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, Analizës, Tarifave dhe Statistikave**.

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 23, Kreu II të VKM-së nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar.

11. Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **12.04.2024**.

12. **Njoftimi fituesit do të publikohet:** në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **16.04.2024**.

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

II. NGRITJE NË DETYRË

1. Shpallje për ngritje në detyre për plotësimin e vëndit të lirë të punës në AKEP:

Në zbatim të Kreut V të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe Kreut III të VKM-së nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) shpall procedurat për pozicionin:

Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, Analizës, Tarifave dhe Statistikave Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore Kategoria e pagës III-a (III-1)

2. Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

- MISIONI :

Siguron me profesionalizëm dhe përgjegjësi zbatimin e funksioneve të njësisë organizative në kuadër të veprimtarisë së AKEP si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe postare, lidhur me analizën e tregjeve përkatëse, mbikëqyrjen dhe rregullimin e tarifave të ofrimit të shërbimeve, vendosjes së masave rregullatore si dhe administrimit dhe përpunimit të të dhënave, sipas ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS:

Përgjegjësi i Sektorit të Kërkimeve, Analizës, Tarifave dhe Statistikave përgjigjet përpara Drejtorit të Drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore për përmbushjen nga sektori që drejton, të funksioneve në lidhje me analizën e tregjeve përkatëse, mbikëqyrjen dhe rregullimin e tarifave të ofrimit të shërbimeve, vendosjes së masave rregullatore si dhe administrimit dhe përpunimit të të dhënave, sipas ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim që të mund të përmbushet misioni dhe objektivat rregullatore.

- DETYRAT KRYESORE:

Përgjegjësi i Sektorit të Kërkimeve, Analizës, Tarifave dhe Statistikave siguron që:

- 1) T’i japi hollësite e nevojshme eprorit direkt me qëllim që funksionet e drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore në lidhje me analizën e tregjeve përkatëse, mbikëqyrjen dhe rregullimin e tarifave të ofrimit të shërbimeve, vendosjes së masave rregullatore si dhe administrimit dhe përpunimit të të dhënave, sipas ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, të zbatohen nga nëpunësit në përbërje të sektorit duke bërë ndarjen e punës sipas pozicioneve dhe detyrave përkatëse, për zbatimin e procedurës dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore të parashikuara në legjislacionin material të fushës dhe atë të përgjithshëm, si dhe të realizimit të objektivave sipas strategjisë dhe planit të veprimit.

- 2) T'i japi hollësi eprorit direkt me qëllim që të sigurojë që njësitë organizative në përbërje të drejtorisë, të ushtrojnë veprimtarinë dhe përmbushin detyrat sipas funksionit që kanë, si dhe të bashkërendojnë dhe koordinojnë aktivitetin për të garantuar mbarëvajtjen e proceseve të punës sipas procedurës, që nga marrja e detyrave deri në përmbushjen e plotë të tyre.
- 3) Proceset e punës dhe detyrat e ngarkuara nga Titullari për sektorin, të realizohen me cilësi, efektivitet dhe brenda afateve ligjore.
- 4) T'i japi hollësi eprorit direkt që procesi i raportimit në çdo nivel sipas hierarkisë të jetë i qëndrueshëm, eficient dhe në funksion të qëllimit për të cilin zbatohet.
- 5) T'i japi hollësi eprorit direkt që bashkëveprimi dhe përmbushja e detyrave të caktuara nga Titullari në kuadër të grupeve të punës dhe bashkëpunimit me drejtoritë e tjera të AKEP të kryhet sipas procedurës, akteve të nxjerra për këtë qëllim si dhe efektshmëri të plotë.
- 6) Të japi hollësi që mbikëqyrja dhe monitorimi i tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike për tregun e shumicës dhe atë të pakicës të kryhet rregullisht dhe në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore.
- 7) Të japi hollësi që analizat e tregjeve sipas përcaktimeve ligjore të kryhen në afatet e parashikuara ligjërisht dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet rregullatore në fuqi.
- 8) Të japi hollësi që vendosja e masave rregullatore për sipërmarrësit e deklaruar me Fuqi të Ndjeshme në Treg të zbatohet në përputhje me rezultatet e analizave së tregjeve përkatëse dhe kuadrit ligjor dhe rregullator për këtë qëllim.
- 9) T'i japi hollësi eprorit direkt që të përgatiten rekomandimet dhe opinionet e karakterit rregullator për Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, për çdo çështje në shqyrtim si dhe për çështje që lidhen për dhënien e mendimit institucional mbi projektakte ligjore dhe nënligjore të adresuara nga organet që disponojnë sipas Kushtetutës dhe ligjit të drejtën e nismës ligjore.
- 10) Të japi hollësi që administrimi dhe përpunimi i të dhënave statistikore të depozituara nga sipërmarrësit të kryhet në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të AKEP.
- 11) T'i japi hollësi eprorit direkt që bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës, të garantojë zbatimin e detyrimeve ligjore dhe të shërbejë për marrjen e masave preventivuese sa më të efektshme për parandalimin e sjelljeve antikonkurruese nga ana e sipërmarrësve në dëm të konsumatorit/përdoruesve.
- 12) T'i japi hollësi eprorit direkt që sipërmarrësit dhe AKEP të përmbushin detyrimet ligjore lidhur me transparencën dhe publikimin e informacionit për përdoruesit e rrjeteve/shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe ato të shërbimeve postare.
- 13) T'i japi hollësi eprorit direkt që përditësimi i informacionit të ardhur nga organizatat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë dhe AKEP aderon, për çështjet që lidhen me funksionet e sektorit, të shërbejë për zbatimin e detyrimeve ligjore, përmirësimin e kuadrit rregullator dhe rritjen e standardeve të punës në këtë drejtim.
- 14) Të japi hollësi që kontributi i drejtorisë në lidhje me procedurat për planifikimin dhe zbatimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe buxhetit të AKEP, të kryhet në kohë, me cilësi dhe efektivitet.

3. Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë :

Arsimi : Të zotërojë diplomë “Master Shkencor” në fushën e Shkencave Ekonomike.

Përvoja : Të ketë eksperiencë profesionale në fushën e rregullimit ekonomik, në fushën administrative, dhe organeve rregullatore të fushave të tjera.

Të tjera : Të detyrueshme,

- Njohuri të thelluara dhe eksperiencë profesionale, në nivelin menaxherial në fushën e rregullimit ekonomik.
- Njohuri shumë të mira praktike në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve aplikative të administrimit të të dhënave dhe aftësi për të përpunuar të dhëna teknike.
- Njohja e gjuhës angleze e çertifikuar në nivel profesional. Çdo gjuhë e huaj tjetër përbën avantazh.
- Aftësi analitike dhe krijuese për zgjidhjen e situatave komplekse.
- Njohuri dhe interes i vazhdueshëm për të qenë në korrent të parimeve dhe praktikave më të mira për rregullimin e konkurrencës *ex-post* në vendet e BE dhe më gjerë.
- Njohuri dhe interes i vazhdueshëm për të qenë i informuar vazhdimisht me vendimet e nxjera nga Këshilli Drejtues, organizatat ndërkombëtare të fushës ku Republika e Shqipërisë/AKEP aderon të cilët janë gjithnjë orientues në punë.
- Aftësi vet-motivuese për të punuar i pavaruar brenda afateve kohore të ngushta në një mjedis pune intensiv, me qëllim përgatitjen e dokumenteve rregullatore.
- Aftësi vet-organizuese, dhe aftësi krijuese për të dhënë sugjerime dhe propozime të dobishme për ecurinë e punës.
- Aftësi shumë të mira për të relatuar me shkrim dhe me gojë në nivelet më të larta drejtuese.
- Të ketë aftësi koordinuese e mbikqyrëse të punës në drejtori.
- Të ketë cilësitë e nevojshme për të drejtuar punën në grup.

4. Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët, për këtë procedure, janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë” ;
- ç- Të plotësojë kushtet e tjera të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil;
- d- Të përmbushë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

5. Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokollit të AKEP, dokumentet e dosjes së tij personale:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta>.
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID) ose Pashaportës.
- Fotokopje të diplomave.
- Fotokopje të listës se notave.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë).
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Aktin e emërimit si nëpunës civil.
- Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.

- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
 - Formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas linkut <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-i-vetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-ose-ushtrojne-funksione-publike->
6. Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e Protokollit, të Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Rr. Reshit Çollaku, brenda datës **03.04.2024**.
7. **Rezultatet për verifikimin paraprak** të kandidateve që përmbushin kushtet dhe kërkesat e vecanta, të përcaktuara në shpalljen në konkurim do të dalin në datë **13.04.2024** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të AKEP. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.
8. **Konkurimi**
- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **24.04.2024 ora 10:00**.
 - **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **24.04.2024 ora 12:30**.
9. **Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Punes
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Punes
- Kodi i Procedurave Administrative
- Kodi Civil
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”i ndryshuar dhe akteve nënligjore të tij;
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligjin 119/2014 “Për të drejten e informimit”
- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
- Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 ”Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” i ndryshuar
- Ligjin nr. 9918, datë 19.08.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, (<http://www.akep.al/legjislacioni/ligje>)
- Ligjin Nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” (<http://www.akep.al/legjislacioni/ligje>)
- RREGULLORE

- <https://akep.al/legjislacioni/rregullore>
<https://akep.al/sherbim-postar/rregullore>
- <http://www.akep.al/legjislacioni> (Ligj, VKM, Rregullore, në faqen zyrtare të AKEP).

10. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyre në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **20** pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. **40** pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. **40** pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, për zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, Analizës, Tarifave dhe Statistikave**

Kandidati fitues, është ai që renditet i pari nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70 % të pikëve). Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikes 23, Kreu II të VKM-së nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar.

11. Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **24.04.2024**.

12. **Njoftimi fituesit do të publikohet:** në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **30.04.2024**.